

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Blerje automjet Fadrome, Bashkia Puke

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Automjete 34100000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

4,583,000 (Katermilion e peseqinde e tetedhjetë e tremijë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/ date 05.032009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**, i ndryshuar

Kerkohet vitet e fundit duke marre ne konsiderate vleren e objektit dhe per te qen sa me konkruese per te gjithë op.ekonomin te vegjel apo te medhenj.

2.2.2.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për **të paktën një nga vitet** e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: *Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke pare vleren e fondit limit te percaktuar e cila nuk eshte e larte dhe vlera 40% e fondit limit per xhiro vjetore nuk cenon pjesmarrjen e op.ekonomik as atyre qe jan biznes i vogel duke garantuar konkurrence te hapur dhe mos cenimin e asnje op.ekonomik.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohej për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë operatorin ekonomik të vegjel apo të mëdhenj. *Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben AK për të vërtetuar se operatorin ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632,datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë

datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit për këto objekte mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedurë vendoset për të demonstruar që operatorët ekonomikë kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë operator ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

a. Operatorët ekonomikë të paraqesë dokumentacionin teknik ligjor që posedon mjetin në çdo formë ligjore sipas ligjit Shqiptarë që vërteton se ka posedim të ligjshëm mbi këto mjete që ofron dhe të dhëna që është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara si dhe foto të mjeteve. Si dhe adresën ku ndodhet mjeti i ofruar. Mjeti duhet të ketë dokumentacionin e plotë juridik sipas legjislacionit shqiptarë përfshirë dhe doganën e paguar ose operator ekonomik të marrë për shpallje fitues do marrë për shpallje likuidimin e vlerës për plotësimin e dokumentacionit sipas legjislacionit shqiptarë përfshirë dhe doganën. Ky dokumentacion do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues paraprak, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:**

Kriteri është i mbështetur në nenin 40 pika 6 dhe 8 të VKM nr. Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Ky kriter është vendosur për të dëshmuar qartë operator ekonomik vërteton se ka posedim të ligjshëm mbi këto mjete që ofron në çdo formë ligjore sipas ligjit Shqiptarë dhe janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara si dhe foto të mjetit. Gjithashtu merr për shpallje plotësimin me dokumentacionin teknik si leje qarkullimi e vlefshme, sigurancë dhe taksa automjetesh dhe me anë të një deklaratë për të mos diskriminuar asnjë operator ekonomik që në momentin e hedhjes së ofertës mund të ketë mjetin të pa targuar apo paisur me dokumentacion përkatës. Kjo bëhet pasi vlera e doganës është përfshirë në fondin limit nga ana e preventivuesit.

b.Grafiku i levrimit 30 dite pas lidhjes se kontrates eshte percaktuar si kohe e nevojshme per furnizimin objekt i ketij prokurimi duke marre parasysh qe mjeti mund te ndodhet brenda territorit Republikes Shqiperise apo dhe jashte sajë per te qen afat i mjaftueshem per te siguruar konkurrence te drejte dhe te ndershme dhe ne perputhje me afatet per zbatimin e projektit te BE.

c.Garanci 1 vit per defektet qe mund te kete mjeti.

*Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri është vendosur për te garantuar qe produktete qe ofrohen te jen nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe qe garanton furnizimin sipas sasive te percaktuara dhe specifikimeve teknike .*

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialist i jashtem i përcaktuar nga Titullari AK ne mungese te nje Inxhinieri Mekanik ne Bashkine Puke ndersa vlera nga preventivuesi duke bere studimin e tregut .

### **Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:**

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

*Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

Preventivuesi, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë shërbim, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për mënyrën e përlogaritjes të vlerës së prokurimit bazuar në nenin 76 të VKM 285 date 19.05.2021.

***Sa i përket respektimit të pikës “a”, grupi i Punës ka kontrolluar ne faqen zyrtare Institutit të Statistikave (INSTAT), për të marre informacion mbi çmimet për objekt” duke specifikuar të***

*dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre artikujve që Autoriteti Kontraktor “DPPGJ” kërkon. INSTAT nuk disponon çmime të botuara për këte lloj procedure.*

- ***Sa i përket respektimit të pikës “c”, grupi i Punës nuk mund të marrë si shembull cmimet e kontratave të mëparshme të realizuara pasi nuk është realizuar ndonjëherë një shërbim apo blerje e tillë.***

Preventivuesi, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje malli, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës ( fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

- ❖ ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Preventivuesi, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

Preventivuesi ka kontaktuar me këto subjekte që operojnë në treg, për marrjen e ofertave. Format e komunikimit me subjektet e tregut kanë qenë ato të parashikuara në ligj dhe në varësi të rrethanave dhe mundësive reale të komunikimit. Subjektet që veprojnë në këtë sektor, janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike të kërkesave tona, për sa i përket, dhe identifikimit të artikujve në treg, në mënyrë që këta të fundit të kishin mundësi të analizonin dhe të jepnin ofertat e tyre të përafërta, Preventivuesi ka marrë në treg 3 (tre) oferta ekonomike.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

#### **Njesia Prokurimit**